



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT
BORDI

Nr. 63 / prot
13

Tiranë më 24 / 02 / 2026

PROCESVERBAL
MBLEDHJE BORDI
(Datë, 24/02/2026)

Të pranishëm nga Bordi: Të pranishëm nga Bordi: Mentor Beqa, Alma Liço-Gjurgji, Etleva Smaçi, Simon Mirakaj, Laureta Roshi, Vasil Tole.

Të pranishëm nga ISKK: Çelo Hoxha (*Drejtor Ekzekutiv*), Franceska Loshe (*Specialist Jurist, për mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes*).

Rendi i Ditës:

1. Diskutim mbi heqjen nga e drejta e përdorimit të ISKK e godinës së ish të përndjekurve politikë, me VKM nr.189 dt. 06.02.2026.
2. Zgjedhja e një anëtari të Këshillit Shkencor
3. Të tjera

M.Beqa: Hapim mbledhjen e sotme dhe kalojmë në shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës. Në vijim të daljes së VKM nr. 189, ISKK aktualisht nuk disponon ambiente për zhvillimin e veprimtarisë së tij. Godina është hequr nga administrimi dhe ISKK gjendet para një fakti shumë problematik, megjithëse janë ndjekur të gjitha hallkat institucionale përkatëse, deri më tani nuk kemi marrë asnjë përgjigje zyrtare.

Keni propozime?

V.Tole: Problematika qëndron në faktin se është bërë heqja e godinës, por nuk është përcaktuar ende se ku do të sistemohet në vijimësi me zyra ISKK. Propozoj që të hartohet një shkresë zyrtare nga Bordi, për Këshillin e Ministrave dhe për dijeneri Kuvendit të Shqipërisë se deri më tani nuk është caktuar ambienti ku do të ushtrojë veprimtarinë ISKK, si dhe për të kërkuar një zgjidhje sa më të shpejtë duke qënë se kushtet e punës janë të papërshtatshme. Shkresës t'i bashkëlidhet organika e ISKK-së, si edhe përlllogaritja e sipërfaqes në m² të nevojshme për ambiente pune, në përputhje me standardet më të fundit në fuqi. Mendoj që shkresa të përfundohet deri të premtën dhe të dërgohet brenda kësaj jave. Këtë mendim kam dhe e shoh si vetmen zgjidhje.

L.Roshi: A ju është përcjellë ndonjë vendim zyrtar në momentin kur u lirua fillimisht godina dhe u morën ambiente me qira?

Ç.Hoxha: Jo vetem shkresë.

V.Tole: Keni dërguar shkresa të tjera ndërkohë?

Ç.Hoxha: Po, kemi vepruar edhe pas daljes së VKM nr. 189. Që në vitin 2022, në momentin kur morëm shkresat për lirimin e godinës, i kemi vënë në dijeni në rrugë zyrtare institucionet përkatëse përmes shkresave për situatën që gjendemi. Në atë kohë kemi marrë përgjigje se nuk disponoheshin hapësira në dispozicion për ta na sistemuar. Më pas kemi shkruar disa herë, por deri më sot nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga institucionet përkatëse.

M.Beqa: Ne si Bord duhet ta dërgojmë shkresën, ose të kerkojmë shtesë buxheti.

E.Smaci: Unë sugjeroj që të merren si referencë edhe institucionet homologe, për të parë se ku i kanë zyrat dhe si janë të organizuar nëse kanë ndertësa të vecanta. Gjithashtu, do të ishte e udhës që të përfshihej edhe media për t'i dhënë zë problemtikës. Për këtë aspekt mund të na ndihmojë edhe Laureta.

M.Beqa: Jeni dakort?

Anëtarët e Bordit janë dakord për dërgimin e shkresës.

Shënim: Ora 14:20, Drejtori Ekzekutiv i ISKK Çelo Hoxha largohet nga mbledhja.

M.Beqa: Kalojmë në pikën 2 të rendit të ditës, që ka të bëjë me zgjedhjen e anëtarit të Këshillit Shkencor. Janë paraqitur dy kandidatura nga të cilat do të përzgjidhet vetëm një, sipas shpalljes së bërë.

Lexohen emrat e dy kandidatëve që kanë aplikuar për anëtar të Këshillit Shkencor.

Anëtarët e Bordit bien dakord për mënyrën dhe formatin e fletës së votimit. Printohet fleta e votimit me emrat e dy kandidatëve, ku secili anëtar duhet të zgjedhë 1 (një) kandidat. Fletët e votimit u shpërndahen të gjithë anëtarëve të Bordit. Pas votimit nga secili anëtar, kutia e votimit hapet nga Kryetari i Bordit, i cili nis procesin e numërimit të votave për secilin kandidat.

Në përfundim të numërimit, Kryetari i Bordit lexon numrin e votave të grumbulluara nga secili kandidat.

M.Beqa: Votat e marra nga secili kandidat janë si vijon:

- Edlira Titini – 5 vota
- Jonila Godole – 1 votë

Nga ky rezultat, kandidatet fituese shpallet Znj. Edlira Titini. I urojmë suksese.

Nëse nuk ka më diskutime apo mendime të tjera, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Mentor Beqa.....


Simon Mirakaj.....


Etleva Smaçi.....


Loreta Roshi.....


Alma Liço-Gjurgji.....


Vasil Tole.....


Përpiloi: Franceska Loshe

